



UNIVERSITETI SHITËROR I TETOVËS

STATE UNIVERSITY OF TETOVA - ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

SUT Rectorate - Ilinden nn, 1200 Tetovo, Macedonia

Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222, email: international@unite.edu.mk

RAPORT

**PËR VETEVALUIMIN E UNIVERSITIT TË TETOVËS
GJATË VITEVE AKADEMIKE 2013/14, 2014/15, 2015/16**

Tetovë, 2017

Përmbajtja

1. Hyrje

2. Konteksti institucional

2.1. Zhvillimi historik

2.2 Statusi i Universitetit

2.3 Pozita gjeografike e institucionit

2.4. Struktura, stafi akademik dhe teknik si dhe studentët

2.5. Statusi i Universitetit në lidhje me kërkesat e evaluimit të jashtëm

2.6. Situata rajonale dhe nacionale e tregut të punës

3. Normat, vlerat, misioni dhe qëllimi i Universitetit

3.1. Vizioni, misioni dhe qëllimet strategjike të Universitetit

3.2. Qeverisja dhe menaxhimi

3.3. Profili i Universitetit

4. Qeverisja dhe aktivitetet

4.1. Qeverisja institucionale dhe vendimmarrja

4.2. Kultura e kualitetit

4.3. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

4.4. Aktivitetet kërkimore

5. Strategjitë për udhëheqje dhe kapaciteti për ndryshime

Hyrje

Universiteti i Tetovës, me seli në Tetovë, anëtar i Asociacionit të Universiteteve Evropiane (AUE), duke ndjekur strategjitë e programeve institucionale për evaluim, fuqishëm është orientuar drejt përforsimit të kapaciteteve të tij, me qëllim të rritjes së kualitetit në Universitet. Senati i Universitetit, më 01.04.2011, për herë të parë krijoi Komisionin për Evaluim, të përbërë nga 9 anëtarë, tre prej të cilëve ishin studentë të propozuar nga Parlamenti Studentor. Në hapat e parë të evaluimit u realizua anketimi i studentëve, si pjesë e vetevaluimit, kurse raporti i vetevaluimit u miratua nga senati më 17.10.2012. Në fillim të vitit 2014, me krijimin e komisionit (pas skadimit të afatit katërvjeçar të komisionit paraprak) u hap edhe Zyra për Menaxhim me Cilësi dhe Evaluim me qëllim të krijimit të infrastrukturës dhe mbështetjes së Komisionit për Evaluim si dhe menaxhimit të cilësisë në Universitet. Gjatë periudhës në vijim, në të gjitha njësitë akademike të Universitetit u krijuan komisionet për evaluim të njësisive akademike nga këshillat mësimorë shkencorë të fakulteteve në përbërje prej 7 anëtarëve, dy prej të cilëve nga radhët e studentëve, me mandat katër vjeçar, respektivisht dy vjeçar.

Më 29.10.2015 Senati i Universitetit solli vendim për formimin e Komisionit për Evaluim me këtë përbërje: Prof. Dr. Arbër Çeliku, Kryetar i Komisionit për Evaluim nga Fakulteti Filologjik, Doc. Dr. Shpresa Memishi nga Fakulteti i Kulturës Fizike, Doc. Dr. Fatbardha Ismaili nga Fakulteti Juridik, Doc. Dr. Festim Halili nga Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Dr. Sheherzada Murati nga Fakulteti Ekonomik, Mr. Sheruze Osmani nga Fakulteti Filozofik. Studentët e propozuar nga Parlamenti Studentor si anëtarë të Komisionit për Evaluim janë: Bledina Isaku, studente në Fakultetin Juridik, Besmir Bexheti, student në fakultetin e Kulturës Fizike dhe Agron Fazlija, student në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore. Dokumentet që janë në shërbim të Komisionit për Evaluim, që i ka sjellë Senati janë: udhëzuesi për evaluim të njësisive akademike si dhe pyetësori për anketim të studentëve.

Komisioni u obligua që të realizojë procesin e evaluimit dhe të përpilojë e raportin e vetevaluimit për periudhën 2013/14, 2014/15, 2015/16, në të cilin do të merren parasysh udhëzimet për vetevaluim të Bordit për Akreditim dhe Evaluim të R. së Maqedonisë, si edhe kahet për evaluim

institucional të AUE-së. Struktura dhe përmbajtja e raportit përfshijnë kahet e AUE-së për evaluim institucional: evaluimi i institucioneve të larta në R. e Maqedonisë. Tri aspektet specifike të evaluimit të institucionit në tërësi janë: vlerësimi i kualitetit të programeve studimore, vlerësimi i kualitetit të stafit akademik dhe vlerësimi i kualitetit të aktiviteteve hulumtuese.

Që të realizohej suksesshëm procesi i evaluimit të Universitetit ishte i nevojshëm bashkëpunimi me të gjitha njësitë akademike të Universitetit. Në këtë drejtim, fillimisht u njoftuan të gjitha palët duke filluar prej stafit akademik, administrativ e deri te studentët. Më 23.11.2015 komisioneve të njësive akademike iu dërgua njoftim për fillimin e procesit, me qëllim që informata të përcillet te i gjithë stafi dhe te studentët. Vijuan takimet diskutuese të komisioneve për evaluim të njësive akademike me përfaqësues të Komisionit Qendror dhe Zyrës për Menaxhim me Cilësi dhe Evaluim. U diskutuan kërkesat që dalin nga udhëzuesi i njësive akademike për evaluim si dokument i Universitetit për evaluim, i cili shërben për evaluim të Universitetit si obligim ligjor (Gazeta Zyrtare e RM-së) dhe statutar (Gazeta Zyrtare e RM-së). Gjatë procesit të evaluimit, komisionet realizonin takime së paku një herë në muaj për aktivitetet dhe vështirësitë që kishin hasur gjatë procesit të evaluimit. Gjatë takimeve ftonin edhe përfaqësues nga Komisioni Qendror ose Zyra për Menaxhim me Cilësi dhe Evaluim. Pas hartimit të raporteve si dhe miratimit të të njëjtave në këshillat mësimore-shkencorë të njësive akademike, raportet iu adresuan kryetarit të komisionit qendror për evaluim, Prof. Dr. Arbër Çeliku. Njëkohësisht anëtarët e Komisionit Qendror i ndanë aktivitetet për gjurmim dhe morën përgjegjësi për realizim të pjesëve të caktuara të raportit. Si rezultat i raporteve të njësive akademike për evaluim si dhe aktiviteteve gjurmuese shtesë, në takimet mujore, anëtarët e Komisionit Qendror diskutonin dhe trajtonin punën e realizuar me qëllim që të arrihet një analizë sa më objektive. Në prill të vitit 2016 përfaqësues të Komisionit Qendror për Evaluim morën pjesë në prezantimin e evaluimit të jashtëm nga përfaqësues të AUE-së.

Me qëllim të vlerësimit objektiv dhe të paanshëm në të gjitha sferat e veprimtarisë në Universitet, komisioni solli vendim për realizim të procesit të vetevaluimit të Universitetit nga ana e ekspertëve të AUE-së.

Vështirësitë me të cilat u ndesh Komisioni Qendror kishin të bëjnë me sasinë e madhe të të dhënave dhe llojlojshmërinë e raporteve të njësive akademike. Raporti është shqyrtuar dhe miratuar nga Rektori dhe Senati. Sipas rregullave ligjore, raporti i evaluimit, së bashku me raportin për evaluim institucional të AUE-së do të shpallen në web faqen e Universitetit dhe do të dërgohen në Ministrinë e Arsimit të Republikës së Maqedonisë.

2. Konteksti institucional

2.1. Zhvillimi historik

Universitetit i Tetovës është themeluar më 17 dhjetor 1994 si iniciativë e intelektualëve shqiptarë, shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme apolitike, arsimore dhe të gjithë dashamirëve të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë. Zhvillimi i UT-së ndahet në dy periudha: 1994-2003 si dhe 2004 e më tej. Periudha prej vitit 1994 deri në vitin 2003 është koha historike e krijimit të Universitetit. Vendimi i kuvendit të intelektualëve shqiptarë për themelimin e një institucioni të lartë arsimor në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë ishte i papranueshëm nga Qeveria e shtetit, e si rrjedhojë Universiteti funksiononte si i paregjistruar (palegalizuar). Me këtë nënkuptohet se ishte edhe i pafinancuar nga organet shtetërore të Republikës së Maqedonisë. Veprimtaria e Universitetit kishte të bëjë me realizimin e mësimin, i cili zhvillohej në objekte private, në salla mësimi të improvizuara, ku ligjëronin profesorë nga vendi, por dhe profesorë nga Universiteti i Prishtinës dhe ai i Tiranës. Ndryshe, Universiteti i Tetovës njihet edhe si Universitet i themeluar me gjak, pasi një ditë pas ligjëratave të para, në shkurt të vitit 2005, në mbrojtje të objektit të Universitetit, në ndeshje me forcat policore ndërroi jetë njëri prej protestuesve.

Në kuadër të Universitetit funksiononin 6 fakultete me gjithsej 13 drejtime: Juridik, Ekonomik, Filozofik, Filologjik, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore si dhe Fakulteti i Arteve. Gjatë viteve në vijim u themeluan edhe dy fakultete, edhe atë: në vitin 1996 Fakulteti i Kulturës Fizike, kurse në vitin 2000/2001 edhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore me dy drejtime: Mjekësi e përgjithshme dhe Stomatologji.

Nga viti 2004 deri më sot pason periudha e zhvillimit institucional dhe koha e modernizimit akademik të UT-së. Në janar të vitit 2004, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë solli ligj të veçantë për themelimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, me të cilin Universiteti fitoi statusin e institucionit për arsim të lartë publik në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë, me seli në Tetovë. Drejtimet e fakulteteve: Filozofik, Filologjik, Arteve si dhe Kulturës Fizike u bënë pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane, kurse Qendra Politeknike, si shkollë e lartë, funksiononte me dy drejtime të reja, edhe atë: të ndërtimtarisë dhe të bioteknologjisë. Fakulteti i Shkencave Mjekësore pushoi së funksionuari. Në vitin 2004 në Universitet funksionin këto fakultete:

- Fakulteti Matematiko-Natyror;
- Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve,
- Fakulteti Ekonomik,
- Fakulteti Juridik, dhe
- Qendra për Studime Politeknike si shkollë e lartë profesionale.

Në vitin 2008 aprovohet ligji i ri për Universitetin Shtetëror të Tetovës, me të cilin u ndryshua dhe u plotësua ligji i vitit 2004. Me këto ndryshime në Universitetin Shtetëror të Tetovës përsëri aprovohen si fakultete të veçanta fakulteti Filozofik, Filologjik, Fakulteti i Arteve, Fakulteti i Kulturës Fizike si dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore, kurse Qendra për Studime Politeknike u transformua në fakultet të veçantë si Fakultet i Shkencave të Aplikuara. Në të njëjtin vit u themeluan edhe Fakulteti i Administratës Publike si dhe Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit. Me këtë, Universiteti Shtetëror i Tetovës ishte i strukturuar me 11 fakultete, 35 programe studimore dhe rreth 93 drejtime.

Dhjetë vitet e fundit ndryshimet në Universitet kanë qenë të fokusuar në krijimin e programeve të reja studimore, të cilat janë në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës si dhe profileve deficitare në rajon.

2.2 Statusi i Universitetit

Universiteti i Tetovës është institucion publik i arsimit të lartë dhe është universiteti i parë publik në gjuhën shqipe në R. e Maqedonisë. Veprimtaria e Universitetit rregullohet me Ligjin për arsim të lartë dhe Statutin e Universitetit. Akti themelor i Universitetit është Statuti i Universitetit, miratimin e të cilit e aprovon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Organi më i

lartë është Senati i Universitetit, me të cilin udhëheq Rektori. Në procesin e vendimmarrjes në Universitet marrin pjesë edhe prorektorët, dekanët, shefat e programeve studimore, këshillat mësimorë/shkencorë si dhe organet tjera të Universitetit.

Universiteti i Tetovës është institucion autonom, i cili vendos për misionin, strategjinë, strukturën, aktivitetet, vendimmarrjen, realizimin e mësimdhënies, veprimtarisë hulumtuese si dhe menaxhon raportet me institucionet dhe universitetet tjera. Të gjitha aktivitetet e realizuara në Universitet janë në përputhshmëri me ligjin dhe aktet e Agjencionit për Akreditim dhe Evaluim të arsimit të lartë në RM. Rektori çdo vit raporton për veprimtarinë para Senatit. Senati miraton raportin vjetor për punën e Universitetit dhe sjell plan vjetor financiar të Universitetit.

Dhënia e llogarisë dhe përgjegjësia e Universitetit shprehen përmes: përgatitjes dhe publikimit të raporteve vjetore për punën e bashkësisë universitare; përgatitjes së raporteve për punën financiare para këshillit për zhvillimin dhe financimin e arsimit të lartë për shfrytëzimin e mjeteve nga këshilli; krijimit të sistemit të brendshëm për vlerësimin e efikasitetit dhe kualitetit në realizimin e veprimtarive të Universitetit dhe informimin e opinionit të gjerë përmes Agjencisë për Evaluim dhe Këshillit për Akreditim.

2.3 Pozita gjeografike e institucionit

Selia e Universitetit të Tetovës është në Tetovë, në njërin prej katër qyteteve më të mëdha në R. e Maqedonisë. Qyteti i Tetovës shtrihet në pjesën veriperëndimore të R. së Maqedonisë, në pjesën e poshtme të fushës së Pollogut, rrethuar me Malin Sharr dhe Malin e Thatë, zë sipërfaqe prej 1080 km dhe me lartësi mbidetare prej 460-500m. Tetova gjendet në udhëkryqin e korridoreve ndërkombëtare qarkulluese, siç janë: korridori 8, që kalon nëpër qytetin e Tetovës si dhe korridori 10, që është 40km larg Tetovës.

Universiteti i Tetovës është njëri prej pesë universiteteve publike në R. e Maqedonisë dhe universiteti i parë publik në gjuhën shqipe, ku ofrohen studime edhe në gjuhën maqedonase dhe atë angleze.

Universiteti i Tetovës posedon tokë prej 351432 m² si dhe 36646 m² hapësirë për realizim të mësim, hulumtimeve dhe praktikës së studentëve, laboratorë, biblioteka, hapësirë për stafin administrativ.

Qendra e Universitetit, ku janë të vendosur Rektorati si dhe katër fakultete, Filozofik, Filologjik, Juridik dhe Ekonomik zë hapësirë prej 17.028 m² dhe gjendet në pjesën perëndimore të qytetit. Po në atë kompleks janë edhe fakulteti i Kulturës Fizike, Shkencave Aplikative, Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit si dhe Fakulteti i Arteve në godinë prej 4232m². Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore gjendet 1.5 km larg qendrës së Universitetit dhe zë hapësirë prej 2899m². Hapësirat e Fakultetit të Shkencave të Mjekësisë gjenden në qendër të qytetit, në kompleksin e Spitalit Klinik në Tetovë, në objekt prej 2251m². Po në qendër të qytetit janë edhe hapësirat e vendosura në Pallatin e Kulturës së qytetit, në objekt me 840m², që shërbejnë për nevojat e programeve studimore të Fakultetit të Arteve.

Fakulteti i Administrimit të Biznesit vepron në qytetin e Kumanovës, rreth 63 km distancë ajrore ose rreth 90 km distancë tokësore nga qyteti i Tetovës dhe është i vendosur në objekt me sipërfaqe 2586m². Studimet e disperzuara realizohen në qytetin e Kërçovës, në objekt prej 1051m², në Dibër në objekt prej 1157m² dhe në Strugë në objekt prej 709m².

Në Universitetin e Tetovës në vit regjistrohen rreth 4500 studentë, duke i përfshirë të tre ciklet studimore, edhe atë studentë nga vendi, por edhe nga rajoni si: Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Serbia si dhe Turqia.

2.4. Struktura, stafi akademik dhe teknik si dhe studentët

Universitetin e Tetovës e përbëjnë 11 fakultete, 60 programe studimore dhe mbi 100 drejtime. Në UT realizohen studime të ciklit të parë të dytë dhe të tretë (Shtojca 1).

Në 41 programe studimore studimet kryesisht zgjasin katër vjet, në 16 programe studimore studimet zgjasin nga 3 vjet, kurse 2 programe studimore janë nga 5 vjet si dhe një program studimor me kohëzgjatje gjashtëvjeçare (Shtojca 5). Studimet realizohen në dy mënyra: studime të rregullta dhe me korrespondencë. Programet të cilat janë specifike si dhe kërkojnë mentorim

dhe praktikë nuk ofrojnë studime me korrespondencë si p.sh. Mjekësia e përgjithshme, Artet, Psikologjia, etj. Në UT mësimi kryesisht realizohet në gjuhën shqipe. Në disa programe studimore të Fakultetit Filologjik mësimi realizohet edhe në gjuhën maqedonase. Në të gjitha programet studimore, ku numri i studentëve që kërkojnë të mësojnë në gjuhën maqedonase është 10 ose më i lartë, atëherë sigurohet mësim edhe në gjuhën maqedonase.

Studime të ciklit të dytë realizohen në 11 Fakultete, 39 programe studimore dhe 90 drejtime të ndryshme. Përgjithësisht studimet zgjasin një vit, kurse në 12 drejtime studimet zgjasin nga 2 vite (Shtojca 6). Cikli i tretë i studimeve realizohet në pesë fakultete, të cilat ofrojnë gjithsej 14 programe studimore (Shtojca 7).

Numri i studentëve aktiv në UT për vitin 2015/16 është 10888 studentë, prej tyre 10484 në ciklin e parë të studimeve, 364 në ciklin e dytë, si dhe 40 në ciklin e tretë të studimeve (Shtojca 8).

Në retrospektivë tre vjeçare numri i studentëve shkon në rënie, prej 11871 për vitin 2013/14, në 10888 për vitin akademik 2015/16 (Shtojca 9). Disa prej faktorëve të cilët kontribuojnë në zvogëlimin e numrit të studentëve janë shpërngulja e familjeve në botën perëndimore, zvogëlimi i natalitetit si dhe vënia në pauzë e programeve studimore, të cilat kishin grupe të disperzuara në qytete të ndryshme.

Numri i stafit akademik të rregullt në UT për tre vitet akademike 2013-2015 është rreth 300. Në vitin 2014/15 kemi rënie minimale, si pasojë e faktit që një pjesë e stafit është pensionuar. Përsëri gjatë vitit 2015/16 numri i stafit të rregullt arrin në 323. Trendi i bashkëpunëtorëve është në zvogëlim e sipër, duke marrë parasysh se me kalimin e viteve ata rizgjidhen duke kaluar në kategorinë e mësimdhënësve. Duke parë se proporcioni mësimdhënës-student është (1/53), kurse për bashkëpunëtorët (1/57), por edhe faktin e disperzimit të grupeve të studentëve në pesë qytete të Maqedonisë, që paraqet vështirësi fizike për mbulimin e realizimit të procesit të mësimdhënies, është e dukshme nevoja e angazhimit të stafit akademik, si mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë me kontratë në vepër. Ky numër i angazhimit të stafit akademik me kontratë për të tre vitet akademike është rreth 150 për mësimdhënës profesor dhe rreth 300 për bashkëpunëtorë asistent (Shtojca 9).

Resurset kadrovike në UT përfshijnë edhe kuadrin administrativ, i cili në nivel të Universitetit është 118, prej të cilëve 63 në njësitë akademike kurse 55 në shërbimet e Rektoratit. Për shkak të ngarkesës së kuadrit administrativ në student ($10888/63=172.8$) janë të angazhuar me kontratë në vepër nga buxheti i UT-së edhe rreth 60 administratorë për njësitë akademike. Stafin teknik e përbëjnë 54 persona (Shtojca 10).

Përveç procesit mësimor, stafi akademik i UT-së realizon edhe veprimtari shkencore, hulumtuese, të cilat stafi i publikon në forma të ndryshme, si në konferenca, publikime në revista. UT-ja ka edhe programim ndërkombëtar Erasmus (Iniciativa Evropiane për këmbim të të rinjve), më të cilin studentët, por edhe mësimdhënësit, një semestër janë pjesë e universiteteve tjera, si dhe gjithashtu studentët të huaj janë pjesë e Universitetit tonë (shtojcë). Universiteti merr pjesë edhe në projekte vendore e ndërkombëtare si: **IPA-CBC, Patterns, Lyra Wallet, RRPP, Twining** etj (Shtojca 11).

Gjithashtu Universiteti ka bashkëpunim me universitetet vendore nga rajoni, Evropa dhe Amerika (Shtojca 12).

Në UT mësimi realizohet në 29 amfiteatro, 146 klasa, 52 laboratorë, 4 biblioteka, 3 leximore si dhe hapësirë për skulptura, piktura e grafikë (Shtojca 4).

2.5. Statusi i Universitetit në lidhje me kërkesat e evaluimit të jashtëm

Evaluimi i jashtëm dhe vetevaluimi i universiteteve janë rrjedhojë e Ligjit për Arsim të Lartë dhe Statutit të Universitetit. Metodologjia e evaluimit të jashtëm dhe vlerësimi i kualitetit të Universitetit në tërësi rregullohen me rregulloren e Bordit për Akreditim dhe Evaluim. Evaluimin e jashtëm të Bordit për Akreditim dhe Evaluim e realizon komisioni i përbërë prej anëtarëve të propozuar nga ENQA, të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RM-së (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 151/2012). Vlerësimi i Bordit për Akreditim dhe Evaluim është i rregulluar me udhëzuesin për vlerësim. Ai bazohet në kriteret e veprimtarisë së institucioneve të larta arsimore dhe është i orientuar në katër fusha: menaxhimi organizativ (zhvillimi i institucioneve të larta arsimore dhe kërkimore-shkencore, sigurimi i kualitetit të brendshëm,

kulturë kualiteti, resurset njerëzore, menaxhimi financiar), mësimdhënia dhe mësimnxënia (procedura për sigurim të kualitetit të programeve studimore, kuadrit akademik, procedura e vlerësimit të studentëve, informimi i studentëve, etj); hulumtimi, zhvillimi dhe aktivitetet kreative (planifikimi strategjik i veprimtarisë kërkimore-shkencore, sistemi i mbështetjes së veprimtarisë kërkimore-shkencore, sistemi i financimit të punës kërkimore-shkencore etj) si dhe arsyeshmëria shoqërore si informim i publikut, qëllimet strategjike për mësim të përjetshëm dhe popullarizimi i aktiviteteve kërkimore-shkencore (Gazeta Zyrtare e RM-së. nr. 167/2013).

Procesi i evaluimit në njësitë akademike dhe në Universitetin e Tetovës realizohet çdo 3 vjet. Raportet e njësive akademike krijohen sipas udhëzuesit për vetevaluim dhe vlerësim të kualitetit të njësive akademike, në të cilin janë të përfshirë standardet e AUE-së. Udhëzuesi është miratuar nga Senati i Universitetit. Vetevaluimin e njësive akademike e realizojnë komisionet e fakulteteve, të zgjedhur nga këshilli mësimor-shkencor i fakultetit, kurse vetevaluimin e Universitetit e realizon Komisioni Qendror për Evaluim i zgjedhur nga Senati.

2.6. Situata rajonale dhe nacionale e tregut të punës

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, fuqia aktive punuese për vitin 2016 karakterizohet me nivel të ulët me 56.5, niveli i punësimit me 43.1 dhe niveli i lartë të papunësisë me rreth 23.7%. Pjesën dërmuese të të papunësuarve e përbëjnë të rinjtë.

Sipas të dhënave të Entit për Punësim në RM vërehet se vende të lira pune ofrohen për mjeshtër zanatesh, që nuk kërkojnë diplomë të arsimit të lartë si: shitës, kamerier, hidraulik, automekanik, zdrukthëtar etj. Profesionet më të kërkuara që përfshijnë kualifikim me arsim të lartë janë nga fusha e shkencave kompjuterike, matematikës, fizikës, kimisë, agrikulturës dhe shkencat e veterinarisë.

Sipas analizës së Agjencionit për Punësim, në nivel nacional, punëdhënësit deklarojnë se ndeshen me vështirësi të plotësimit të vendeve të punës: se nuk mund të gjejnë punëtorë me veprimtari përkatëse, mungesë e përvojës së punës, mungesë e njohurive dhe shkathtësive për realizim të detyrave të punës që dalin nga vendi i punës.

Ndryshimi i strukturës së ekonomisë, ku ka zvogëlim të rolit të sektorit prodhues, rritja e rëndësisë së shërbimeve, avancimi i shërbimeve dhe internacionalizimi, janë fakte se fundamentet në të cilat punojnë firmat janë ndryshuar, me çka edhe rritet nevoja për punëtorë me arsimim të lartë. Si rezultat i kësaj, punëdhënësit kërkojnë punëtorë me arsimim formal të përshtatshëm dhe me shkathtësi, trajnime përkatëse si dhe aftësi e shkathtësi komunikuese ndërnjerëzore.

Prioritetet kombëtare për zhvillim të resurseve njerëzore në strategjinë nacionale për zhvillim të arsimit për periudhën 2016-2020 janë të orientuara në qëllimet kyçe, siç janë: 1. Krijimi i mundësive të kapshme që të gjithë të rinjtë të përfitojnë njohuri (njohuri, qëndrime, shkathtësi) të cilat kërkojnë në tregun e punës; 2. Promovimi i qasjeve afatgjate dhe ndërsektoriale në politikat për ndihmë të punësimit të të rinjve; 3. Të rinjtë si partnerë kreativ dhe proaktiv në procesin e tejkalimit të papunësisë; 4. Sigurimi i mbështetjes sistematike dhe të koordinuar për zhvillim të sipërmarrjeve të reja.

Në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për arsim të lartë kërkohet afrimi i profileve arsimore me tregun e punës. Në këtë drejtim është orientuar edhe Universiteti ynë duke sjellë ndryshime dhe adaptime në programet studimore, me qëllim që të përputhen shkathtësitë, të cilat ofrohen nga programet studimore si dhe kërkesa e shkathtësive në tregun e punës. Prandaj, programet studimore realizohen në mënyrë që 10% e lëndëve obligative dhe 10% e lëndëve zgjedhore të kenë mësim klinik (mësimi realizohet nga profesionisti i praktikës në fushën e caktuar). Gjithashtu, studentët e programeve studimore, si pjesë e studimeve, ndjekin praktikën në institucione të caktuara. Në këtë drejtim, Universiteti ka nënshkruar bashkëpunim me institucione të ndryshme publike si: ministrinë, gjykatat themelore në disa qytete, komunat, entin shtetëror për pronësi industriale, qendrën për punë sociale, spitalin e Tetovës, spitalin psikiatrik të Bardovcit, shkollat fillore dhe të mesme nëpër qytete të ndryshme si Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë etj.

Duke marrë parasysh analizat e tregut të punës, Universiteti hapi programe studimore të fushës së informatikës si: Telekomunikime dhe teknologji kompjuterike, Matematikë financiare, Informatikë biznesi.

Në vitin 2012, në nivel të Universitetit është hapur edhe Qendra për karrierë me qëllim që të menaxhohet, orientohet si dhe të lehtësohet realizimi i pjesës praktike të studentëve, por edhe kalimi në tregun e punës.

3. Normat, vlerat, misioni dhe qëllimi i Universitetit

3.1. Vizioni, misioni dhe qëllimet strategjike të Universitetit

Vizioni i Universitetit të Tetovës është që të jetësojë idealet kombëtare dhe vlerat bashkëkohore në arsim, shkencë dhe kulturë me qëllim zhvillimin dhe përparimin e gjeneratave të ardhshme.

Misioni i Universitetit është të krijojë dhe të avancojë të mësuarit, shkathtësitë, njohuritë, kompetencat akademike dhe profesionale, që do të jenë avancuese të ndryshimeve në shoqëri, në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar. Obligim i Universitetit është të arrijë qëllimet në vijim:

1. Krijimi dhe zhvillimi i programeve studimore të nevojshme për shoqërinë dhe tregun në vend dhe më gjerë.
2. Zhvillimi i infrastrukturës në përputhje me qëllimet dhe natyrën e programeve studimore;
3. Stimulimi dhe kultivimi i lirive dhe arritjeve akademike, mësimore dhe shkencore të studentëve dhe mësimdhënësve;
4. Stimulimi i veprimtarive hulumtuese-shkencore të mësimdhënësve dhe studentëve (*mbështetje të botimit të revistave shkencore, konferencave, librave dhe projekteve të ndryshme shkencore*);
5. Kultivimi i vlerave etike, barazisë, integritetit, tolerancës dhe përgjegjësisë sociale, me qëllim të formimit të studentëve si qytetarë, pjesëmarrës aktivë në shoqëri multikulturore;
6. Evaluimi i vazhdueshëm i procesit mësimor, realizimi i kurrikulave dhe qëllimeve të programit studimor;
7. Mbështetja e studentëve me sukses të dalluar në zhvillimin e karrierës së tyre akademike dhe profesionale.

3.2. Qeverisja dhe menaxhimi

Akti kryesor i Universitetit është Statuti, të cilin e aprovon Kuvendi i republikës së Maqedonisë. Njësitë akademike kanë rregullore, me të cilat rregullohen raportet dhe veprimtaria e njësisë. Rregulloret hartohen në përputhshmëri me Statutin e Universitetit. Plani strategjik del nga misioni dhe vizioni i Universitetit, kurse strategjitë për implementimin e të njëjtit diskutohen nga Senati i Universitetit. Organet e Universitetit janë: Senati i Universitetit, Rektori dhe Këshilli i Rektoratit. Në Universitet formohet Këshilli i Universitetit si organ i tij. Organi më i lartë i vendimmarrjes në Universitet është Senati, me të cilin udhëheq Rektori. Senati përbëhet nga: Rektori i Universitetit, së paku nga 1 përfaqësues nga çdo njësi organizuese, përfaqësues të zgjedhur nga anëtarët shoqërues të Universitetit si dhe përfaqësues nga radha e studentëve (15% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Senatit) të zgjedhur nga Parlamenti Studentor i Universitetit.

Këshillin e Rektoratit e përbëjnë: Rektori, prorektorët, dekanët, përkatësisht drejtorët e njësive të Universitetit dhe kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit. Me Këshillin e Rektoratit udhëheq Rektori. Këshilli i Rektoratit i përgatit dhe i propozon aktet dhe çështjet materiale, për të cilat vendos Senati dhe Rektori. Rektori është organ udhëheqës i Universitetit si dhe e prezanton dhe përfaqëson Universitetin në vend dhe jashtë vendit. Gjithashtu kompetencë e Rektorit është të zbatojë vendimet dhe qëndrimet e Senatit. Ai është i obliguar që të paktën një herë në vit, t'i dorëzojë Senatit, Këshillit Universitar dhe themeluesit, raport për punën e tij dhe të Universitetit. Dhënia e llogarisë dhe përgjegjësia e Universitetit shprehen përmes: përgatitjes dhe publikimit të raporteve vjetore për punën e bashkësisë Universitare; përgatitjes së raporteve për punën financiare para Këshillit për zhvillimin dhe financimin e arsimit të lartë për shfrytëzimin e mjeteve nga Këshilli; krijimit të sistemit të brendshëm për vlerësimin e efikasitetit dhe kualitetit në realizimin e veprimtarive të Universitetit dhe informimin e opinionit të gjerë përmes Agjencisë për Evaluim dhe Këshillit për Akreditim.

Senati miraton raportin vjetor për punën e Universitetit dhe sjell lan vjetor financiar të Universitetit.

Këshillin e Universitetit e përbëjnë anëtarët, të cilët i emëron Senati, persona që nuk janë anëtarë në Senat, mes të cilëve edhe një student. Anëtarët tjerë të Këshillit të Universitetit emërohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Oda Ekonomike e Republikës së Maqedonisë dhe vetadministrimi lokal - Këshilli i komunës së Tetovës. Në punën e Këshillit të Universitetit merr pjesë edhe Rektori pa të drejtë vote. Këshilli i Universitetit e mbikëqyr kryerjen e veprimtarisë në Universitet të paraparë me ligj dhe Statutin e Universitetit, ligjshmërinë në punën e tij, nevojat për resurset kadrovike dhe materiale.

Organet e fakultetit janë: Këshilli mësimor-shkencor, dekani dhe këshilli i dekanatit. Organi kryesor i njësisë është Këshilli mësimor-shkencor. Këshillin mësimor – shkencor e përbëjnë profesorët ordinarë, inordinarë, docentët dhe studentët. Përfaqësimi i studentëve nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit mësimor – shkencor. Obligimet dhe përgjegjësitë e KMSH-ve të njësive akademike janë të rregulluara me Ligjin për Arsim të Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e njësisë akademike. Këshilli i dekanatit përbëhet nga dekani, prodekanët shefat e programeve studimore dhe koordinatorët për ECTS. Çdo program studimor në njësitë akademike ka shefin-përgjegjës me çka edhe rregullohet menaxhimi në linjë deri në organet më të larta të universitetit.

Universiteti i Tetovës, si universitet publik, financohet nga buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga burime tjera të parapara me Statutin e Universitetit, me të cilat mbulohen shpenzimet që dalin nga funksioni integruar, në pajtim me Statutin e Universitetit. Të ardhurat e veçanta udhëhiqen në llogari të veçanta të Universitetit. Me autorizim nga ana e Rektorit dhe në pajtim me Statutin, njësitë që marrin pjesë në krijimin e tyre mund të shfrytëzojnë një pjesë nga këto mjete. Me mjetet që disponon Universiteti mbulohen aktivitetet vijuese: pagat e stafit akademik, administrativ dhe teknik (përfshirë tatimet, kontributet, kompensimet dhe të ngjashme); shpenzimet materiale për punën e organeve, komisioneve, trupave dhe shërbimeve të Universitetit (pajisje për zyrat dhe të ngjashme); investimet kapitale, investimet për mirëmbajtje, amortizim të pronës që e shfrytëzon Universiteti (objekte, pajisje, libra, etj.); zhvillimi dhe zgjerimi i veprimtarisë, e cila realizohet përmes organeve të Universitetit; veprimtaria botuese. Universiteti përgatit plan financiar vjetor, të cilin e sjell Senati. Universiteti përgatit llogari përfundimtare dhe e dorëzon te organet kompetente, në pajtim me rregullat ligjore.

3.3. Profili i universitetit

UT-ja është universitet i integruar, i cili i përfshin gjitha fushat shkencore duke filluar nga shkencat humane dhe artet, shkencat matematike-natyrore, shkencat mjekësore dhe shkencat teknike. Me tendencën për gjithëpërfshirje të fushave të ndryshme shkencore, Universiteti tenton të balancojë edhe procesin e mësimdhënies dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore si dhe raportet me bashkësinë. Prej këtij viti akademik në UT është themeluar edhe shkolla doktorale sipas modeleve të universiteteve evropiane me çka edhe procesi mësimor bëhet i tërësishëm dhe ofron proces mësimor të vazhdueshëm për tri cikle studimore që reflekton bashkëkohësinë e procesit mësimor-shkencor. Rritja e mobilitetit të studentëve gjatë dy viteve të fundit akademike është tregues se Universiteti synon t’i tërheqë studentët e huaj përveç atyre vendës.

Realizimi i mësimit dhe krijimi i kuadrit akademik me kualitet të lartë është një prej tendencave të vazhdueshme të Universitetit. Të gjitha programet studimore, veprimtarinë e tyre e ushtrojnë sipas sistemit të Bolonjës, që është në përputhshmëri edhe me Ligjin për Arsim të Lartë. Me këtë, Universiteti fokusohet që veprimtaria mësimore-shkencore të ndjekë standardet ndërkombëtare. Në të gjitha programet studimore aplikohet parimi “studenti në qendër të arsimit” dhe kombinohen mësimdhënia, të nxënies, vlerësimi i vazhdueshëm sipas kompetencave specifike. Universiteti gjithashtu është aktiv në të gjitha projektet nacionale që kanë të bëjnë me nxitjen e arsimit si studime të disperzuara dhe projekti 35/45, përmes të cilave mundësohet arsimimi i të rriturve.

Universiteti i Tetovës në vazhdimësi ndjek nevojat e tregut të punës në rajon dhe shoqëri, si të sektorit publik edhe të atij privat. Në këtë kontekst përshtaten programet studimore si dhe akreditoohen programe të reja studimore, në fusha të cilat janë me kuadër deficitar. Telekomunikimet dhe teknologjia kompjuterike, gjeoinformatika, inxhinieria e komunikacionit dhe transportit, gjeodezia dhe gjeoinformatika janë disa prej programeve studimore të akredituara dy viteve të fundit akademike. Megjithatë, edhe pse politikën e regjistrimit të studentëve si dhe orientimin e prioriteteve akademike e krijon universiteti, përsëri e njëjta revidohet dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Me qëllim të profesionalizimit dhe në përputhshmëri me Ligjin për Arsim të Lartë studentët realizojnë praktikë si në institucione e kompani publike ashtu edhe në ato private, me qëllim që të rritet në nivel sa më ta lartë raporti teori-praktikë si dhe sipërmarrësit të kenë mundësi profesionalisht të stimulojnë kuadrin e ri potencial.

UT-ja edhe pse me histori relativisht të re ka studentë që kanë fituar bursa nga kompania Google në kuadër të programit Google Anita Borg Scholarship. Universiteti bën përzgjedhjen e studentëve me të arritura më të larta në lëmin e shkencave kompjuterike me qëllim të stimulimit të vajzave që të studiojnë në lëmi të Informatikës. Gjatë vitit akademik 2014/15, studentët e UT-së morën vend të parë në garën rajonale studentore “Hackathon”, të organizuar nga kompania Google në bashkëpunim me UT-në. Në këtë garë studentë të universiteteve të ndryshme nga rajoni prezantuan idetë e tyre softuerike dhe robotë që lehtësojnë punën e njerëzimit.

UT-ja anon drejt arritjes së krijimit të partneritetit me biznes bashkësinë në vend. Për këtë qëllim është hapur edhe Zyra për marrëdhënie dhe ndërlidhje me bizneset, ka vijuar edhe nënshkrimi i një sërë memorandumesh edhe atë:, me agjencione dhe organizata për përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrjeve dhe me ndërmarrjet nga industria e ndërtimitarisë, ushqimore, turizmit, sektori i distribuimit etj.

3.4. Pozita e Universitetit në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar

Universiteti i Tetovës bashkëpunon me institucione, organizata, asociacione të ndryshme si rajonale, nacionale dhe ndërkombëtare. Stafi i Universitetit, së bashku me studentët, kontribuon në forma të ndryshme në zhvillimin e shoqërisë me pjesëmarrje direkte dhe indirekte në jetën e bashkësisë lokale, por edhe atë nacionale e ndërkombëtare. Organizimi i shfaqjeve teatrale, ekspozitave vendore dhe ndërkombëtare dhe koncerteve, janë disa prej aktiviteteve që begatojnë jetën kulturore si në nivel rajonal ashtu edhe në atë regional. Dhënia e konsultave për shërbime të ndryshme si për menaxhim të bizneseve, pjesëmarrjes në debate në lidhje me tema të dukurive shoqërore, testimi i cilësisë së ushqimit, testimi i materialeve ndërtimore, dhënia e shërbimeve mjekësore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një prej karakteristikave në të cilat orientohet Universiteti me qëllim të ndjekjes së tendencave evropiane dhe botërore, që do të çonte drejt një bashkëpunimi akademik, me këmbim të përvojave të kontribuohet në zhvillimin e shkencës dhe inovacioneve. Universiteti është anëtar i disa asociacioneve ndërkombëtare. Përveç European University Association (EUA) ai është anëtar edhe i Observatory Magna Charta Universitatum, me qendër në Bolonjë, Itali; European Club of Rectors, me qendër në Oxford, Britani e Madhe, ku në takimin e fundit Rektorit, prof. dr. Vullnet Ametit, iu nda çmimi për cilësi më të mirë “European Quality Award”. Ai është pjesë edhe e Eurasian Universities Union (EURAS) me qendër në Stamboll, Turqi si dhe Ballkan Universities Association, (BUA) me qendër në Edrene Turqi.

Universiteti fokusohet në internacionalizimin e procesit të mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore, profesionalizimit edhe të stafit administrativ (shtojcë). Tregues për këtë janë edhe lëvizjet e para të stafit akademik, studentëve dhe stafit administrativ gjatë vitit 2013/14 nëpërmjet programit MEVLANA, kurse gjatë vitit akademik 2014/15 janë edhe përvojat e para me ERASMUS +, me tendencë për rritje të këtij numri gjatë vitit 2015/16.

4. Qeverisja dhe aktivitetet

4.1. Qeverisja institucionale dhe vendimmarrja

UT paraqet universitet të integruar, organizimi dhe veprimtaria e të cilit bazohet në autonominë institucionale. Organet vendimmarrëse janë të strukturuar në 3 nivele: në nivel universitar, në nivel të njërive akademike dhe programeve studimore.

Organet e universitetit janë: Senati i Universitetit, Këshilli i Rektoratit dhe Rektori. Senatin e përbëjnë Rektori, si anëtar i Senatit sipas funksionit, respektivisht kryetar i Senatit, nga dy përfaqësues të fakulteteve si dhe tre përfaqësues të studentëve. Përfaqësuesit e fakulteteve zgjidhen nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit me votim të fshehtë, kurse studentët zgjidhen nga Parlamenti Studentor. Prorektorët dhe Sekretari gjeneral marrin pjesë në mbledhjet e Senatit, por pa të drejtë vote. Anëtarët e Këshillit të Rektoratit, përkatësisht dekanët dhe prodekanët e fakulteteve nuk mund të jenë anëtarë të Senatit.

Senati është organi që siguron autonominë e Universitetit, sjell vendime, rregullore, udhëzime dhe përfundim. Senati është kompetent për të sjellë Statutin e Universitetit dhe rregulloret punës. Ai vendos për politikën akademike, aktivitetet akademike (miraton programet studimore të propozuara paraprakisht nga fakultetet, përcakton fushat shkencore dhe lëmenjtë mësimorë në të cilët ushtrohet veprimtaria e universitetit etj.) çështjet financiare (sjell plan financiar vjetor të Universitetit, sjell llogari përfundimtare financiare vjetore dhe raport vjetor financiar të Universitetit), bën zgjedhjen e stafit akademik (sjell rregullore për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore dhe mësimore, zgjedh profesorë të rregullt; vendos për dhënien e titujve doktorë nderi të shkencave), publikime (sjell rregullore për organizimin e veprimtarisë botuese).

Rektori është organi që e udhëheq dhe e prezanton Universitetin. Zgjedhja Rektorit kryhet në bazë të kriterëve për propozim dhe zgjedhje të Rektorit dhe prorektorëve, të cilat i sjell Senati. Këshillat mësimorë – shkencorë të fakulteteve dhe këshillat e instituteve shkencore në përbërje të Universitetit propozojnë kandidatë për Rektor nga përbërja e tyre, që nuk është e thënë të jenë nga radha e të punësuarve në Universitet. Kandidati për Rektor përcaktohet me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm në Këshillin mësimor – shkencor. Këshilli i Rektoratit, në bazë të propozimeve, me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, sjell propozim për 2 kandidatë të mundshëm për t'u zgjedhur Rektor. Procedurën për përcaktimin e propozimit të zgjedhjes së Rektorit e rregullon komisioni zgjedhor i përbërë prej 3 anëtarësh, të cilin e zgjedh Këshilli i Rektoratit. Rektorin e zgjedh Senati me votim të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë.

Disa nga kompetencat kyçe të Rektorit janë: e udhëheq Universitetin, e harmonizon aktivitetin e arsimit të lartë, punën hulumtuese - shkencore dhe aplikative, veprimtaritë artistike dhe punët tjera të Universitetit. Në përputhshmëri me Ligjin për Arsim Lartë i thirr dhe udhëheq me mbledhjet e Senatit dhe Këshillit të Rektoratit, u delegon kompetenca prorektorëve për kryerjen e një pjese të të drejtave dhe obligimeve të tyre.

Rektori është i obliguar, të paktën një herë në vit, t'i dorëzojë Senatit, Këshillit Universitar dhe themeluesit, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, raport për punën e tij dhe të Universitetit. Rektori është përgjegjës për ligjshmërinë dhe zbatimin e Statutit.

Këshillin e Rektoratit e përbëjnë: Rektori, prorektorët, dekanët, përkatësisht drejtorët e njësisive të Universitetit dhe kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit. Në punën e Këshillit

të Rektoratit merr pjesë edhe Sekretari i përgjithshëm i Universitetit, pa të drejtë vote. Disa nga kompetencat e Këshillit të Rektoratit janë: të përgatit dhe të propozojë aktet dhe çështjet materiale, për të cilat vendos Senati, për aktivitetet akademike, shpall konkurs për regjistrimin e studentëve të ciklit të parë të dytë dhe të tretë, me pëlqimin paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, shpall konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve dhe sjell vendim për zgjedhjen e tyre (profesorë inordinar, docent dhe asistent-doktorant) në njësitë e Universitetit dhe për punëtorët e shërbimit profesional të Universitetit, jep mendim për programet studimore në njësitë e Universitetit, jep propozime për organizime, mbledhje, simpoziume, këshillime, për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Këshilli i Rektoratit formon komisione profesionale dhe organe tjera punuese për studimin dhe përgatitjen e propozimeve për çështje nga sfera e punës së organeve të Këshillit të Rektoratit: Komisioni për arsim; për shkencë; për financa, investime dhe zhvillim; për bashkëpunim me Universitetet në vend dhe jashtë vendit; veprimtari botuese; veprimtari normative; standardin e studentëve; kulturë dhe sport; teknologji informative. Sipas nevojës, Këshilli i Rektoratit mund të formojë edhe komisione të tjera.

Organizimi i njësive akademike rregullohet me rregullore që është e unifikuar për të gjitha njësitë. Organet e fakultetit janë: Këshilli mësimor-shkencor, dekani dhe këshilli i dekanatit.

Organi profesional i njësisë është Këshilli mësimor-shkencor, të cilin e përbëjnë profesorët ordinarë, inordinarë, docentët, si dhe studentët, të cilët i zgjedh Parlamenti Studentor, numri i të cilëve nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit mësimor – shkencor. Kompetencat e këshillit mësimor-shkencor të fakultetit janë sjellja e rregullores, programit katërvjeçar për zhvillim dhe programit vjetor për punë; propozon kandidatë për dekan deri te Rektorit, propozon programe studimore deri te Këshilli i Rektoratit. Këshillit të dekanatit i drejtohet me propozime për themelimin dhe zhvillimin e këshillit mësimor-shkencor, për risitë në punë dhe për sukseset e studentëve të talentuar, vendos përparimin e mësimin, punën kërkimore-shkencore e aplikative dhe rrjetin kompjuterik. Gjithashtu i zgjedh anëtarët e Komisionit për Evaluim të brendshëm dhe sjell udhëzim për evaluimin e njësive. Vendimet të cilat i sjell Këshilli mësimor-shkencor janë në lidhje me bibliotekën, sistemin informativ-bibliotekar, për realizimin e informatave bibliotekare dhe

veprimtarinë dokumentuese, vendos për organizime, mbledhje, simpoziume, këshillime dhe të ngjashme si dhe për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, të paraparë me Statutin e Universitetit. Gjithë organet kanë përgjegjësit apo udhëheqësit, të cilët përcjellin propozimet e diskutuara në organet e nivelit më të lartë të universitetit, të cilat i miraton ose jo Senati.

Punët administrative realizohen nga shërbimi administrativ-Rektorati, me të cilin udhëheq Sekretari gjeneral i Universitetit. Shërbimi administrativ realizon aktivitete që kanë të bëjnë me kontabilitet e statistikë, përgatit dhe analizon materiale të nevojshme për veprimtarinë e Universitetit, realizon aktivitete në lidhje me rrjetin kompjuterik, aktivitete në lidhje me publikime si dhe punë tjera administrativo-teknike. Shërbimet administrative të njësive akademike janë të organizuara varësisht nga numri i studentëve, stafit dhe nevojës për punë në njësitë akademike. Me punën e tyre udhëheq sekretari i fakultetit. Me sekretarët e fakulteteve udhëheq Sekretari i përgjithshëm i Universitetit. Puna administrative e njësive akademike është e koordinuar me punën administratës qendrore-Rektoratit.

Vendimet në lidhje me aktivitetet akademike për programet studimore, metodat e punës, veprimtarinë hulumtuese-shkencore propozohen dhe diskutohen në programet studimore të njësive akademike të Universitetit. Propozimet pastaj shqyrtohen dhe debatohen nga komisionet përkatëse si dhe miratohen nga Këshilli mësimor-shkencor në përputhshmëri me ligjin, Statutin dhe Rregulloren e njësive akademike. Pas dhënies së mendimit pozitiv nga Këshilli i Rektoratit të njëjtat votohen në Senat.

Politika e resurseve njerëzore është e orientuar në zbatimin e qasjes dhe kriterëve jodiskriminuese për zgjedhje dhe avancim të stafit akademik. Për zgjedhje dhe rizgjedhje të stafit akademik zbatohen kriteret që dalin nga Ligji për Arsim të Lartë si dhe kriteret nga rregullorja për pranim të kuadrit akademik, nëpërmjet të cilit me pikë vlerësohen njohuritë dhe veprimtaria e kandidatit për thirrjen përkatëse në të cilën aplikon.

Politika kadrovike në UT është fenomen mjaft kompleks pasi varet nga më tepër faktorë e mes tjerash është në lidhshmëri direkte edhe me mënyrën e financimit. Në mënyrë vjetore akademike analizohet nevoja e punësimit të kuadrit akademik, profesorëve dhe bashkëpunëtorëve. Në vazhdimësi nga Universiteti drejtohet kërkesa te organet kompetente, respektivisht Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Numri i përgjithshëm i stafit akademik gjatë vitit akademik 2013/14 është 322. Pre tyre 190 mësimdhënës dhe 132 bashkëpunëtorë, kurse gjatë vitit akademik 2015/16 numri arrin në 323, prej të cilëve 204 profesorë dhe 119 bashkëpunëtorë. Vështirësia në sigurimin e vendeve të reja të punës për stafin akademik nga Qeveria e RM-së bën që një numër i konsiderueshëm i stafit të angazhohet me kontratë në vepër, pagesa e shërbimeve të të cilëve mbulohen nga buxheti vetanak i UT-së.

Vendimet ne lidhje me financat

Vendimet në lidhje me zgjedhjen dhe avancimin e kuadrit akademik janë të rregulluara nëpërmjet kriterëve dhe procedurave për zgjedhjen e thirrjeve mësimore – shkencore dhe thirrjeve shkencore, që janë të përcaktuara me ligj dhe me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, shkencore dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve të Universitetit, sipas kriterëve të vetme për zgjedhje, të përcaktuara nga konferenca ndëruniversitare. Zgjedhjet dhe rizgjedhjet për të gjitha thirrjet të kuadrit akademik realizohen nëpërmjet konkurseve publike. Raportet e komisioneve recensuese publikohen në Buletinin e Universitetit, i cili është publik. Avancimin në thirrjen mësimore profesor ordinar (i rregullt), i cili vjen si propozim i njësisë akademike ku konkurren kandidatit, e miraton Senati i Universitetit. Kurse avancimet në thirrjet profesor inordinar, docent dhe asistent doktorant, pas miratimit nga Këshilli mësimor-shkencor i njësisë akademike, i miraton Këshilli i Rektoratit. Në lëmin e shkencave filologjike, Universiteti mund të angazhojë lektorë ose mësimdhënës, nga vendi dhe nga jashtë, për realizimin e veprimtarisë mësimore. Kushtet, procedura për angazhimin e këtyre kuadrove, të drejtat dhe obligimet e tyre përcaktohen me Rregulloren e Fakultetit Filologjik. Mësimdhënësit në thirrjet mësimore-shkencore zgjidhen për fushat përkatëse, të përcaktuara me klasifikim të fushave shkencore, sferave dhe lëmive, sipas standardeve të OECD-së dhe aktit të Këshillit të Rektoratit të Universitetit.

Kuadri administrativ punësohet nëpërmjet konkursit publik në pajtim me Ligjin, Statutin dhe Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës së Universitetit. Me kuadrin administrativ udhëheq Sekretari i përgjithshëm, u jep udhëzime udhëheqësve dhe nëpunësve tjerë, si dhe të punësuarve në Universitet, veçanërisht në kontekstin e udhëheqjes me resurset njerëzore. Ai gjithashtu vendos për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e nëpunësve administrativë sipas

mënyrës dhe procedurës së përcaktuar me Ligjin për nëpunësit administrativë dhe Statutin e Universitetit. Me nëpunësit administrativë të njësisë udhëheq sekretari i njësisë, i cili për punën e tij është përgjegjës para dekanit gjegjësisht drejtorit dhe para Sekretarit të përgjithshëm të Universitetit. Për plotësimin dhe kryerjen e obligimeve të shërbimit profesional të njësisë, të punësuarit për punën e tyre janë përgjegjës para sekretarit të fakultetit dhe Sekretarit të përgjithshëm të Universitetit.

Vendime ne lidhje me regjistrimin e studenteve: Konkursin për regjistrimin e studentëve, me propozim të këshillit mësimor - shkencor dhe me pëlqimin paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e sjell dhe e shpall me vendim Këshilli i Rektoratit. Konkursi publikohet në medie dhe faqen zyrtare të Universitetit në internet, më së voni pesë muaj para fillimit të mësimi. Kriteret për regjistrim të studentëve përcaktohen nëpërmjet suksesit të shkollës së mesme si dhe suksesit në maturën shtetërore ose shkollore. Në fakultetet, respektivisht programet studimore me kërkesa specifike realizohen provime pranuese, në të cilat kandidatët selektohen varësisht njohurive ose shkathtësive e talentit specifik, varësisht profilit të programit studimor. Në UT provime pranuese organizohen në Fakultetin e Shkencave Aplikative (Arkitekturë), Fakultetin e Arteve, Kulturës Fizike, FSHM-së (Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci), Juridik (Kriminalistikë) dhe Fakultetin Pedagogjik.

Çdo vit njësitë akademike propozojnë numër të vendeve të lira të studentëve për programet studimore, kërkesë e cila i drejtohet Këshillit të Rektoratit. Me propozim të Universitetit, Ministria e Arsimit e përcakton numrin e vendeve të lira të studentëve si dhe distribuimin e të njëjtave për fakultete e programe studimore.

Shtetasit e huaj mund të regjistrohen për studime në Universitet. Kushtet e regjistrimit përcaktohen me akt të Këshillit të Rektoratit të Universitetit, gjegjësisht me konkursin për regjistrim të studimeve në të tri ciklet e studimeve universitare. Shtetasit e huaj paguajnë çmim të plotë të studimeve kurse vendimin për shumën e pagesës së semestrit për shtetasit e huaj e sjell Këshilli i Rektoratit. Obligimet, përgjegjësitë dhe të drejtat gjatë studimeve i kanë të njëjta si studentët vendas.

Të drejtë regjistrimi në të tri ciklet e studimeve universitare kanë edhe personat që nuk kanë kryer arsimim ekuivalent jashtë vendit. Vlerësimin për plotësimin e kushteve për regjistrim, përkatësisht përshtatshmërinë e arsimit të kryer jashtë vendit për vazhdimin e shkollimit, për

secilin kandidat në veçanti, e bën Komisioni kompetent i Universitetit. Pas kryerjes së vlerësimit Komisioni sjell vendim, me të cilin verifikohet se: kandidati i plotëson kushtet për regjistrim, përkatësisht për vazhdimin e studimeve; kandidati duhet t'u nënshtrohet provimeve diferenciale, gjegjësisht pjesëve të lëndëve të programeve; ose kandidati nuk i plotëson kushtet për regjistrim, përkatësisht për vazhdimin e studimeve universitare.

Kyçja e anëtarëve shoqërues të Universitetit në vendimmarrjen e Universitetit është e paraparë me ndryshimet e fundit në Ligjin për Arsim të Lartë si dhe Statutin e Universitetit. Kyçja e anëtarëve shoqërues në vendimmarrjen e Universitetit parashihet të realizohet nëpërmjet themelimit të Këshillit të Universitetit të përbërë prej 11 anëtarëve. Gjashtë anëtarë të emëruar nga Senati i Universitetit, nga personat që nuk janë anëtarë të Senatit, njëri prej të cilëve është student i propozuar nga Këshilli i Rektoratit dhe Parlamenti studentor; tre anëtarë i emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë; një anëtar e emëron Oda Ekonomike e Republikës së Maqedonisë; një anëtar e emëron, vetadministrimi lokal - Këshilli i komunës së Tetovës. Në punën e Këshillit të Universitetit merr pjesë edhe Rektori, pa të drejtë vote. Pritet që ky organ të ndihmojë në përmirësimin e avancimin e informimit për nevojat në bashkësi. Këshilli i Universitetit mbikëqyr kryerjen e veprimtarisë në Universitet; kryerjen e punëve në Universitet të paraparë me ligj dhe Statutin e Universitetit, ligjshmërinë në punën e tij, nevojat për resurset kadrovike dhe materiale, kujdeset për autonominë e Universitetit dhe merr masa në rast të cenimit të autonomisë së Universitetit.

Përfshirja e studentëve në vendimmarrje.

Studentët marrin pjesë në udhëheqjen e Universitetit përmes përfaqësuesve të zgjedhur nga Parlamenti Studentor, Parlamenti ndëruniversitar i studentëve, organet e njësive akademike, format e vetorganizimit ose ndonjë formë tjetër, në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj dhe me Statutin e Universitetit. Studentët kanë përfaqësues në të gjitha organet e Universitetit: në Këshilli mësimor-shkencor, Këshillin e Rektoratit dhe Senatin e Universitetit (me të drejtë vote). Studentët gjithashtu janë pjesëmarrës të barabartë edhe në komisionet e njësive akademike. Përfaqësues të tyre janë të kyçur edhe në komisionin për vetevaluim të njësisë akademike si dhe në Komisionit Qendror për Evaluim. Përvoja e deritanishme tregon se studentët nuk e shfrytëzojnë mjaft të drejtën e tyre për të diskutuar në lidhje me vendimet dhe çështjet që kanë të bëjnë me qëllimet strategjike të Universitetit.

Me qëllim që të përforcohet roli i studentëve në vendimmarrje dhe të mbrohen të drejtat e studentëve në Universitet emërohet avokati i studentëve. Avokati i studentëve i mbron të drejtat ligjore të studentëve dhe të drejtat e përcaktuara me aktet e Universitetit, aktet e njësive akademike në përbërje të Universitetit, kur ato shkelen nga ana e organeve të Universitetit, nga organet e njësive akademike, nga personat e përfshirë në procesin edukativo - arsimor dhe nga personat tjerë, të përcaktuar me akt të avokatit të studentëve që e sjell Senati i Universitetit.

Evaluimi i kualitetit është obligim ligjor i institucioneve të arsimit të lartë në RM. Krijimi i udhëzuesit për evaluim të njësive akademike paraqet një standard, në bazë të të cilit Komisionet për Evaluim të njësive akademike e realizojnë evaluimin e njësisë së vet. Evaluimi i njësisë përfshin vlerësim të programit studimor, procesit mësimor, veprimtarisë kërkimore-shkencore, mbështetjen studentore. Pjesë e raporteve të evaluimit është edhe anketimi i studentëve, i cili përfshin: procesin e informimit prej institucionit, respektivisht programit studimor ashtu edhe vlerësimin e procesit mësimor, të praktikës, notimin si dhe perceptimin e tyre për përfitim të kompetencave gjatë studimeve. Analiza përfundimtare nënkupton edhe sugjerime për përmirësim të dukurive, të cilat janë më të mangëta.

Bashkëpunimi ndërinstitutional. Universiteti bashkëpunon dhe kontribuon edhe në zhvillimin e Universiteteve tjera nëpërmjet angazhimit të kuadrit dhe përcjelljes së përvojës në programet e Universiteteve si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Kandidati i zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore në Universitet mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë, gjegjësisht veprimtari artistike në njësi tjetër, në fakultet të Universitetit tjetër, në thirrjen në të cilën është zgjedhur në fushën e njëjtë mësimore-shkencore, gjegjësisht sferën artistike, në bazë të pëlqimit të dhënë nga Rektori i Universitetit. Gjithashtu, Universiteti ka bashkëpunim edhe me subjekte të rëndësishme shoqërore si: Sekretariati për Çështje Evropiane, Fondi për Sigurim Shëndetësor, Agjencioni për Ushqim dhe Veterinari, Komiteti Olimpik i Maqedonisë, Këshilli për Radiodifuzion të RM-së

4.2. *Kultura e kualitetit*

Një prej qëllimeve të rëndësishme të UT-së është edhe investimi në rritjen e kualitetit në Universitet që të jetë konkurrues në tregun vendor, rajonal e ndërkombëtar. Prej këtu del edhe kujdesi për aktivitetet dhe funksionimin e njësive akademike të Universitetit si dhe funksionimi në tërësi. Kontrolli i kualitetit realizohet në të gjitha veprimtaritë në Universitet edhe atë të

njësive akademike, programeve studimore, veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore, menaxhimit, si dhe metodat e mënyrat e punës, mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Një prej mekanizmave që përdoret për avancim të kualitetit është procesi i evaluimit. Në bazë të Ligjit për Arsim të Lartë si dhe të Statutit të Universitetit, në të tri ciklet e studimeve universitare zbatohet sistemi i vetevaluimit më së paku në 3 vjet. Udhëzimet për vetevaluim, sigurimi dhe vlerësimi i kualitetit sillen nga Senati. Vetevaluimi realizohet në të gjitha njësitë akademike të Universitetit nga Komisionet për Evaluim të njësive akademike. Komisionet zgjidhen nga Këshilli mësimor- shkencor si dhe përbëhen nga shtatë anëtarë, dy prej të cilëve janë studentë. Me komisionin udhëheq kryetari i komisionit për evaluim i njësisë akademike. Komisionet, duke u udhëhequr nga udhëzuesi për evaluim të njësive akademike (shtojca të miratuar nga senati), realizojnë evaluimin e programeve studimore, procesin mësimor, kërkimor-shkencor, shkallën e pjesëmarrjes së mësimdhënësve dhe studentëve në realizimin e programeve studimore dhe lëndore, strukturën e studentëve, informimin e studentëve, serviset për mbështetje të studentëve etj. Raporti përmban të dhëna dhe analiza objektive të cilat e reflektojnë gjendjen reale në njësitë akademike përfshirë aspektet pozitive, pjesët jo të fuqishme si dhe masat korrektuese me qëllim të avancimit të kualitetit në njësinë akademike.

Raporti i vetevaluimit shqyrtohet në Këshillin mësimor-shkencor, i cili pas miratimit i drejtohet kryetarit të Komisionit Qendror për Evaluim. Komisioni Qendror për Evaluim, në bazë të hulumtimeve të tij dhe raporteve të komisioneve për evaluimin e programeve studimore, përgatit raport vjetor për rezultatet e evaluimit, me vlerësim të gjendjes dhe propozime për kapërcimin e dukurive negative të konstatuara në zbatimin e veprimtarisë në njësinë akademike.

Pasi zhvillimi dhe avancimi i kualitetit është proces i gjatë dhe ndërlikuar, në Universitet, nga viti 2014 funksionon Zyra për Menaxhim me Cilësi dhe Evaluim. Aktiviteti i deritanishëm ka qenë i orientuar në krijimin e infrastrukturës dhe mbështetjes së komisioneve për evaluim, krijimin e udhëzuesit për evaluim të njësive akademike, përpilimin e instrumenteve matëse, trajnimin e komisioneve për realizim të evaluimit, takimet mbështetëse për implementim të sugjerimeve që dalin nga raportet e evaluimit etj. Pjesë e vetevaluimit është edhe anketimi i studentëve, i cili duke respektuar standardet e AUE-së përfshin: Shkallën e informimit nga fakultetet për procesin e studimeve; Shërbimin studentor; Koordinatorët për ECTS;

Mësimdhënësit në ligjërata dhe ushtrime për çdo lëndë; Kushtet, organizimin e procesit mësimor; Vlerësimin dhe notimin e njohurive; Pjesëmarrjen e studentëve në realizimin e programeve studimore; Kompetencat që fitojnë në çdo lëndë në kuadër të programit. Si rezultat i evaluimit të parë, duke marrë parasysh në veçanti rezultatet e anketimit nga studentët, më tej sugjerimet u orientuan edhe në marrjen e hapave konkrete për përmirësimin e dukurive jo të fuqishme. Më konkretisht, përmirësimi i burimeve të informimit deri te studentët, si organizime të takimeve të koordinatorëve për ECTS me studentë me qëllim të informimit të tyre, orar të provimeve dhe ligjëratave online, plotësim të syllabuseve online etj. Gjithashtu u aktualizua nevoja për anketim të realizimit të orës mësimore në ligjërata dhe ushtrime. Pyetësi i dytë për evaluim të realizimit të orës realizohet menjëherë pas mbarimit të orës konkrete nga anëtarët e komisionit për evaluim të njësisë akademike dhe përfaqësuesve të Zyrës për Menaxhim me Cilësi dhe Evaluim. Studentët dhe mësimdhënësi e vlerësojnë realizimin e orës mësimore, përmbajtjen e ligjëratës, menaxhimin e orës si dhe interaksionin joverbal. Mësimdhënësit marrin në e-mail rezultatet e tyre, të cilat u shërbejnë për vetreflektim dhe orientim në fuqizimin e pikave pozitive si dhe përmirësimin e pikave të dobëta në procesin e mësimdhënies.

4.3. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Në UT janë të përfshira tri ciklet studimore: Cikli i parë i studimeve universitare, cikli i dytë i studimeve pasuniversitare dhe cikli i tretë, studime doktorale. Programet studimore vlerësohen me kredi sipas ETCS. Çdo vit në programet studimore përmban 60 kredi. Programet studimore të ciklit të parë, që përmbajnë 180 deri 240 kredi dhe zgjasin tre deri katër vjet. Varësisht nga lloji i programit ato vlerësohen si profesionale ose si programe studimore akademike. Programet studimore të ciklit të dytë përmbajnë 60 ose 120 kredi varësisht nga kohëzgjatja e ciklit të parë të studimeve, që në total cikli i parë dhe i dytë i studimeve të kapin vlerën e 300 kredive.

Programet studimore të ciklit të tretë mund të përmbajnë 180 kredi ose të jenë të vlerësuara në mënyrë të përshtatshme me karakterin e studimeve të ciklit të tretë, së bashku me 360 kreditë e fituara në ciklin e dytë të studimeve të magistraturës. Këto studime zgjasin tre vjet dhe vlerësohen si studime doktorale.

Programe studimore të caktuara, të cilat janë në lidhshmëri me realizimin e profesioneve të rregullta realizohen të integruara në ciklin e parë dhe të dytë: studimet deridiplomike në fushën e mjekësisë përfshijnë gjashtë vjet studime teorike dhe trajnimi praktik, i cili realizohet në Universitet; studimet bazike të fushës së farmacisë dhe stomatologjisë përfshijnë 5 vjet të studimit në formë të rregullt.

Programet studimore në të gjitha vitet e studimeve përmbajnë lëndë të obligueshme dhe zgjedhore. Lëndët e obligueshme janë të fushës përkatëse të njësisë akademike, respektivisht të njësisë organizative të brendshme dhe numri i tyre përfshin deri në 60% të numrit të përgjithshëm të lëndëve. Pjesën tjetër e përbëjnë lëndët zgjedhore, rreth 30% prej tyre janë lëndë të cilat i zgjedhin studentët nga lëndët e njësisë akademike të universitetit si dhe 10% lëndë zgjedhore të cilat studentët i zgjedhin nga lista e lëndëve të lira zgjedhore të propozuara nga çdo njësi e universitetit. Në ciklin e parë të studimeve, në dy programe studimore: Shkenca politike dhe Informatikë, mësimi dhe testimi realizohen në gjuhën angleze. Në ciklin e dytë të studimeve mësimi dhe testimi në gjuhën angleze realizohet në katër programe studimore: studime politike - marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime evropiane në kuadër të fakultetit juridik, fizikë dhe Informatikë në kuadër të FSHMN-së dhe filozofi - në kuadër të fakultetit filozofik.

Me qëllim që studimet të jenë të kapshme për studentët e njëkohësisht shpenzimet të jenë më të ulëta, Universiteti ka hapur edhe studime të disperzuara në pesë qytete të Maqedonisë: Shkup, Kumanovë, Kërçovë, Strugë, Dibër, Kumanovë.

Stafi akademik realizon mësimdhënien, në qendër të së cilës janë studentët. Këta të fundit janë dhe partnerë në procesin e mësimdhënies nëpërmjet ligjëratave interaktive dhe debateve; mësimi në laboratorë dhe terren, mësimi nëpërmjet TI-së; realizimit të mësimi praktik nëpër shkolla dhe institucione, me të cilat është nënshkruar marrëveshje paraprake bashkëpunimi. Programet studimore në vazhdimësi azhurnohen nga stafi akademik me qëllim të avancimit të kualitetit. Përmbajtjet e programeve studimore të të gjitha cikleve studimore janë të shënuara në ueb faqen e Universitetit. Informimi i studentëve, përmbajtja e programeve studimore, procesi mësimor, niveli i objektivitetit të notimit, janë pjesë të cilat i vlerësojnë studentët në çdo fundvit akademik. Universiteti i Tetovës është tërheqës si për studentët vendorë edhe për ata të huaj, qoftë për të realizuar edukimin e tërësishëm ose për këmbim studentor semestral apo vjetor. Numri i

studentëve shtetas të huaj të regjistruar në njësitë akademike të Universitetit shënon rritje të vazhdueshme. Në vitin akademik 2014/15 janë të regjistruar rreth 1/3 më shumë studentë për dallim prej vitit akademik 2013/14.

Në këtë drejtim shkojnë edhe të dhënat se gjatë vitit akademik 2013/14 nëpërmjet projektit MEVLANA shënohen edhe hapat e parë të këmbimit të studentëve, respektivisht 4 studentë dhe 12 anëtarë nga radhët e stafit akademik të Turqisë kanë qëndruar për një semestër në UT. Prej Universitetit tonë këtë të drejtë e ka shfrytëzuar vetëm një student dhe 7 mësimdhënës (shtojca.). Gjatë vitit akademik 2014-2016 nëpërmjet programit ERASMUS+ 13 studentë e kanë realizuar të drejtën të ndjekin semestrin në universitete të jashtme si dhe dy kanë qenë të pritur në UT për një semestër. Këtë të drejtë e ka shfrytëzuar edhe stafi akademik, prej të cilëve gjatë dy viteve të fundit akademike, në Universitet kanë ligjëruar 17 mësimdhënës të huaj, ndërsa 16 mësimdhënës tanë e kanë shfrytëzuar mundësinë për të ligjëruar në universitete tjera.

UT-ja në vazhdimësi zhvillon plan për *Mbështetje të studentëve*. Prej vitit akademik 2012/13, me qëllim të rritjes së kualitetit dhe stimulim të përkushtimit të studentëve, filloi të zbatohet plani për studentët ekselentë edhe atë i definuar për tri kategori të studentëve. Studentët të cilët kanë arritur notë mesatare 9.5 gjatë vitit akademik kanë studime falas në UT për vitin e ardhshëm. Kategoria e dytë e studentëve të janë të diplomuarit me mesatare të përgjithshme të ciklit të parë mbi 9.80, të cilëve u mundësohet të regjistrojnë ciklin e dytë në UT pa pagesë. Kategoria e tretë u dedikohet të gjithë studentëve me mesatare 10.00 në ciklin e parë të studimeve. Universiteti i mbështet me bursa të studiojnë në Universitetet prestigjioze botërore. Vetëm gjatë vitit akademik 2012/13 rreth 100 studentë e kanë shfrytëzuar këtë për të tri kategoritë. Studime pa pagesë kanë gjithë studentët e kategorisë fëmijë pa prindër (pa një ose të dy prindërit). Varësisht rrethanave shoqërore, Universiteti mbështet studentë të kategorive të caktuara. Gjatë vitit 2015/16, kur dy qytete: Shkupi dhe Tetova në RM u kapluan nga vërshimet, UT ofroi studime pa pagesë për atë vit akademik për të gjithë të rinjtë që vinin nga ato vendbanime. Gjithashtu, për të njëjtin vit akademik, 2015/16, studime pa pagesë kishin edhe studentët e komunës së Kumanovës, qytet që ishte i përfshirë në incident të armatosur.

Me qëllim të njohjes me procesin e ri mësimor, i cili është i ndryshëm nga arsimiti i shkollës së mesme, studentët, veçanërisht ata të vitit të parë informohen nga koordinatoret për ECTS të çdo njësie akademike për karakteristikat kyçe të studimit sipas sistemit të Bolonjës, duke përfshirë

informata rreth vetë programit, sistemit të studimeve, kuptueshmërinë e kredive, domethënien e kategorive të lëndëve etj.

Këmbimi i studentëve paraqet një mundësi të mirë për përfitim të përvojave të reja dhe zgjerim të njohurive. Në këtë kontekst, në vazhdimësi prezantohen projektet për këmbim të studentëve nëpër fakultete si dhe u ndihmohet studentëve që të aplikojnë, të qëndrojnë si dhe ndjekin procesin e rikthimit në UT.

Qendra për karrierë është në shërbim të studentëve, e cila në fakt paraqet urën lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës. Në këtë kontekst, Qendra për karrierë konkretisht proceson realizimin e praktikës së studentëve në institucione të ndryshme.

Në kuadër të fakulteteve të caktuara, siç janë ai i kulturës fizike dhe i arteve, studentët mbështeten në realizimin e ekspozitave të ndryshme, aktiviteteve sportive, si krosi në nivel të Universitetit, turneu i studentëve që përfshin të gjithë fakultetet, fakulteti i kulturës fizike organizon edhe marshe për shënimin e datave të rëndësishme, volejboll plazhi etj. Për vitin e ardhshëm akademik është planifikuar themelimi i klubit të volejbollit për femra dhe për meshkuj në nivel të Universitetit, ku mund të përfshihen gjithë studentët e interesuar prej gjithë programeve studimore.

Me qëllim të rritjes së nivelit të shërbimit të studentëve, planifikohet që prej vitit të ardhshëm akademik të fillojë së funksionuari sistemi elektronik, i cili studentëve do t'u mundësonte informim më të mirëfilltë si dhe arritje më të shpejtë deri në bazë të të dhënave, me çka do të lehtësohej edhe komunikimi i studentëve me shërbimin administrativ, por edhe i mësimdhënësve.

4.4. Aktivitetet kërkimore

Në Universitet organizohet veprimtari kërkimore – shkencore, gjegjësisht veprimtari aplikative, e cila e siguron standardin dhe kualitetin e nevojshëm të procesit mësimor dhe hulumtues, në pajtim me ligjin dhe Statutin e Universitetit. Universiteti e përkrah veprimtarinë e përhershme profesionale (hulumtuese, artistike dhe profesionale) të punonjësve dhe studentëve me interes të përgjithshëm dhe në mënyrë publike i prezanton dhe i shpall rezultatet e veprimtarisë së tillë. Numri i publikimeve në revista shkencore nga stafi i universitetit është në rritje të dukshme (*tabelë me punime*). Mes tjerash kjo del si rezultat i kërkesave ligjore të parapara me Ligjin për Arsim të Lartë për publikim të punimeve shkencore me qëllim të avancimit të stafit. Momenti

motivues është edhe stimulimi financiar nga Ministria e Arsimit për publikime të punimeve shkencore në revista ndërkombëtare me impakt faktor.

Trend i rritjes haset edhe në pjesëmarrjen e stafit në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare (Tabela). Me qëllim të stimulimit të veprimtarisë kërkimore-hulumtuese, vepron Zyra për Hulumtime Shkencore dhe Inovacione (ZSHI), e cila stimulon dhe mbështet organizimin e konferencave shkencore nga njësitë akademike të universitetit (tabela), si dhe publikimin e revistës shkencore në çdo njësi akademike. Qëllimi i Zyrës për Hulumtime Shkencore, mes tjerash, është edhe zhvillimi i punës hulumtuese shkencore në fusha të ndryshme, nxitja e punës kërkimore shkencore brenda Universitetit, ndërtimi i kapaciteteve kërkimore brenda Universitetit, nxitja e bashkëpunimit shkencor mes njësive të Universitetit, bashkëpunimi institucional kërkimor-shkencor brenda dhe jashtë Universitetit dhe të ngjashme. Në kuadër të çdo njësie akademike, në mbështetje dhe stimulim të aktiviteteve kërkimore-shkencore janë edhe dekanët për shkencë. UT-ja organizon konferenca dhe publikime të revistave shkencore. Në kuadër të njësive akademike formohen komisionet, (bordi organizativ i konferencës dhe bordi shkencor) të cilat miratohen nga Këshilli mësimor-shkencor. Universiteti gjithashtu stimulon publikimin e librave universitarë.

Strategjitë për udhëheqje dhe kapaciteti për ndryshime

Ndryshimet dinamike në shoqëri si në vend dhe më gjerë dhe gjithsesi në pajtueshmëri me Ligjin për Arsim të Lartë, në UT në vazhdimësi adaptohen në kërkesat e reja. Duke u bazuar në anët e fuqishme, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet, krijohen planet operative me qëllim të tejkalimit të vështirësive dhe vazhimit të zhvillimit të Universitetit.

Anët e fuqishme:

- ofron programe studimore, studime në fusha të ndryshme shkencore: shkenca mjekësore, shkenca humane, arte, shkenca aplikative, shkenca matematike-natyrore, të cilat në vazhdimësi akreditohen me qëllim që t'i përgjigjen tregut të punës.
- ofron studime në të tri ciklet studimore, që mundëson krijimin e kuadrit profesional
- ofron mundësi studimi për të gjitha programet studimore në të dy gjuhët e vendit, por edhe në gjuhën angleze.
- kuadri profesional me njohuri e përvojë që përcjellin njohuri e shkathtësi te studentët

- infrastrukturë e re me objekte, laboratorë, që mundësojnë zhvillimin e procesit të mirëfilltë mësimor-shkencor.

Anët e dobëta

- numër i madh i studentëve në programe studimore të ndryshme, që vështirësojnë realizimin e procesit mësimor.
- vështirësi në realizimin e pjesës praktike të studentëve për lëndë të caktuara dhe në sipërmarrje e institucione të caktuara.
- zbatim i vogël i mësimit klinik.
- mungesë e ndjekjes së karrierës së studentëve pas diplomimit.
- mungesë e realizimit të një analize të tregut të punës me qëllim të përshtatjes së programeve studimore me nevojën e tregut të punës.
- nevojë për trajnim të stafit për aplikim dhe kyçje në projekte.
- kyçje e ulët e studentëve në organizata dhe aktivitete jashtëmësimore

Mundësitë

- numër i madh i studentëve
- rritja e numrit të studentëve të huaj
- rritja e bashkëpunimit me universitete të huaja që do të mundësojë përcjelljen e përvojave që do kontribuonin në rritjen e kualitetit si dhe zhvillimin e Universitetit.
- kompatibiliteti i programeve studimore me programet studimore evropiane

Kërcënimet

- kritere jotransparente për financim të universiteteve nga buxheti i RM-së.
- mungesa e lejes për punësime të reja të stafit akademik
- shpërngulje e të rinjve dhe familjeve në vendet evropiane
- kriza ekonomike që çon drejt nivelit të ulët të kërkesës për punësim

Përfundim

Duke marrë parasysh SWOT analizën mund të përfundojmë se Universiteti ofron fusha të ndryshme studimore për të rinjtë, me infrastrukturë të re dhe kushte të volitshme për studim dhe që në të ardhmen duhet të kushtojë vëmendje në:

Realizim të analizës së tregut edhe nga ana e Universitetit me qëllim të përputhshmërisë më të madhe që do të shërbente për krijim të planit strategjik afatgjatë në lidhje me dhënien e rëndësisë së programeve studimore. Gjetjen e mekanizmave për realizim më efikas të praktikës së studentëve dhe realizimit të mësimit klinik, stimulim të mobilitetit të studentëve, rritje të numrit të programeve studimore në gjuhën angleze. Gjetje e strategjisë për tejkalim të problematikës së numrit të vogël të stafit akademik si dhe mosaplikimit të Ministrisë së Financave për vende të reja të punës.

Lista e shtojcave:

Shtojca 1. Struktura e UT-së

Shtojca 2. Skema organizuese e menaxhimit të Universitetit

Shtojca 3. Skema organizuese e menaxhimit të njësive akademike

Shtojca 4. Prona dhe hapësirat e UT-së

Shtojca 5. Programet studimore të ciklit të parë

Shtojca 6. Programet studimore të ciklit të dytë

Shtojca 7. Programet studimore të ciklit të tretë

Shtojca 8. Numri i studentëve aktivë gjatë viteve akademike 2013/14, 2014/15, 2015/16

Shtojca 9. Numri i stafit akademik gjatë viteve akademike 2013-2016

Shtojca 10. Numri i kuadrit administrativ

Shtojca 11. Projekte në UT

Shtojca 12. Universitete me të cilat Universiteti i Tetovës ka marrëveshje bashkëpunimi

Shtojca 13. Institucionet me të cilat Universiteti i Tetovës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi

Shtojca 14. Mobiliteti në UT

Shtojca 15. Platforma akademike 2012-2016

Shtojca 16. Organogram i kuadrit administrativ

Shtojca 17. Revistat shkencore të njësive akademike të UT-së të publikuara gjatë viteve 2013/2016